



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në Nenin 57, Shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-391, si dhe bazuar në Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në funksion të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit në institucionet edukativo-arsimore e aftësuese (IEAA) të Komunës së Prishtinës, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) merr:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PRISHTINËS - OPŠTINA PRIŠTINA  
DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË-DIREKCIJA ZA PROSVETU I KULTURU

V E N D I M

03 Nr./Bt. 48 Dt. 04.06.2014

PËR NUMRIN MAKSIMAL TË NXËNËSVE NË KLASË  
NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA

Të gjitha shkollat e mesme të larta të Komunës së Prishtinës, me rastin e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë:

1. Nuk mund të regjistrojnë më shumë se 35 nxënës në klasë dhe ky numër nuk mund të tejkalohet as gjatë vitit shkollor.
2. Nuk mund të lejojnë dallime të mëdha në numrin e nxënësve në mes të paraleleve të të njëjtit drejtim. Dallimi më i madh i lejueshëm në mes të paraleleve mund të jetë 3 nxënës. Drejtoria e shkollës duhet të vendosë për kriteret e ndarjes së nxënësve nëpër paralele, duke siguruar po ashtu edhe proporcionin gjinor brenda të njëjtës klasë dhe në mes të paraleleve.
3. Shkollat që momentalisht kanë klasë me më shumë se 35 nxënës, mund të krijojnë paralele të reja, në mënyrë që në të gjitha klasët të zvogëlohet numri i nxënësve deri në 35, nëse një gjë të tillë e mundëson hapësira shkollore dhe nëse DKA ka mundësi financiare për të angazhuar personelin e nevojshëm.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Drejtorive të IEAA
- DKA-së
- QSHQK

Drejtori  
Jusuif Thaçi  
Prishtinë, më

4 qershor 2014